



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financiare dhe Monitorimit të Fushatës
Sektori për Subjektet Zgjedhore dhe Mandatet

Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR SHOYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. GABRIEL ALTIN GUMA, KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT, NË ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE, NË DISA NJËSI TË QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 9 NËNTOR 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për Kryetar Bashkie”.

Z. Gabriel Altin Guma, është kandidat i propozuar nga zgjedhësit, në Bashkinë Tepelenë, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025.

Për këtë kandidat në datën 24.10.2025, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga KZAZ nr. 80 është përcjellë formulari i vetëdeklarimit.

Nga verifikimi paraprak i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar të Bashkisë Tepelenë, të propozuar nga zgjedhësit, rezulton se, të dhënat e deklaruara nga kandidati nuk përfshihen në kushtet e ndalimit parashikuar nga ligji nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Gabriel Altin Guma, ka shënime në sistem.
- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Gabriel Altin Guma, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Gabriel Altin Guma ku rezultoi se ka deklaruar:

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Gabriel Altin Guma, rezulton:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A keni jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se: Është dënuar nga Gjykata e Vlorës me vendimin nr. 102, 27.02.2024 për veprën penale të parashikuar nga neni 290/1 dhe 290/2 me dënim alternativ.

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 7083, datë 09.11.2025, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 1632/33 prot.extra 25, datë 11.02.2026, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Gabriel Altin Guma”. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Gabriel Altin Guma, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime të gjeneraliteteve apo përdorur gjeneralitete të ndryshme nga ato të deklaruara;
- Rezulton të jetë dënuar, nga Gjykata Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendim të formës së prerë nr. 102, datë 27.2.2024:
 - me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim, për kryerjen e veprës penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal;
 - me 6 (gjashtë) muaj burgim, për kryerjen e veprës penale "Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt", të parashikuara nga neni 291/1 i Kodit Penal.Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të denimeve, është dënuar me 2 (dy) vite burgim, të zbritur, në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, në 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim që, në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, i është pezulluar

ekzekutimi duke u vënë në provë për një periudhë kohe prej 32 muaj me kusht që gjatë kësaj kohe mos kryejë veprë tjetër penale;

- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jo të formës së prerë, nga autoritete shqiptare ose të huaja gjyqësore, për një çështje penale të pa zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;

- Rezulton të ketë qënë në hetim, dhe gjykim, nga:

- Prokuroria e Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, në kuadër të procedimit penal nr. 389 të regjistruar më datë 29.07.2024, për veprën penale "Mosbindje ndaj punonjësit të policisë së rendit publik", të parashikuara nga neni 242 të Kodit Penal, për të cilin, më datë 28.01.2025, është kërkuar, dërgimin për gjykim, para Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, ku vijon të jetë ende në gjykim;

- Prokuroria e Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në kuadër të procedimit penal nr. 1060 të regjistruar me datë 27.09.2023, për veprat penale "Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt" dhe "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", të parashikuara nga neni 291/1 e neni 290/2 të Kodit Penal, për të cilën, me datë 08.01.2024, ka kërkuar, dërgimin për gjykim, para Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e cila e ka deklaruar fajtor dhe dënuar me vendimin nr. 102, datë 27.2.2024, të marrë formë të prerë me datë 15.04.2024.

- Prokuroria e Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në kuadër të procedimit penal nr. 2150 të vitit 2020, për veprën penale "Mosbindje ndaj punonjësit të policisë së rendit publik", të parashikuara nga neni 242 të Kodit Penal, për të cilën, më datë 20.07.2020, ka vendosur pushimin e kësaj çështje, në bazë të nenit 328/1/b të Kodit të Procedurës Penale.

- Nuk rezulton të jetë ndaluar apo arrestuar në flagrancë, nga strukturat ligjzbatuese, për kryerje të ndonjë veprë penale;
- Nuk rezulton t'i jenë caktuar masat shtrënguese sigurimi personal;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se subjekti vetëdeklarues z. Gabriel Altin Guma, kandidat i propozuar nga zgjedhësit, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025, nuk e ka marrë mandatin si Kryetar Bashkie. Referuar nenit 163 të Kodit Zgjedhor subjekti zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat. Në këto kushte subjekti vetëdeklarues, kandidat i propozuar nga zgjedhësit, nuk do të mund të përfitojë mandat si Kryetar Bashkie Tepelenë, për zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025 dhe për rrjedhojë nuk është subjekt i këtij ligji. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka përfutur mandat si Kryetar Bashkie, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur

përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neni 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

Pavlina DOÇAJ -Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financiare dhe Monitorimit të Fushatës

Blendi KODRA -Drejtorja e Ligjshmërisë

Jona JOSIFI -Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)